



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Në bazë të nenit 22 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Kuvendi i FBK-së në mbledhjen e vet të mbajtur më 19.02.2017, miraton aktin normativ

RREGULLORJA MBI PUNËN E KOMISIONIT ARBITRAR TË FBK-së

Neni 1

Me këtë rregullore, rregullohen statusi dhe procedura pranë Komisionit Arbitrar të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Arbitrazhi).

Selia e arbitrazhit është në Prishtinë, në selinë e Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FBK).

Neni 2

Komisionin Arbitrar e zgjedh dhe e shkarkon Bordi i FBK-së. Mandati i Komisionit Arbitrar zgjatë 4 vite.

Neni 3

Komisioni Arbitrar (në tekstin e mëtutjeshëm Arbitrazhi) përbëhet prej tre (3) anëtarëve, Kryetarit dhe dy anëtarëve.

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 4

Kryetari i Arbitrazhit, kryeson dhe udhëheqë me punën e arbitrazhit, si dhe përcakton personin (anëtarin e arbitrazhit), i cili do të hartojë Vendimet e Arbitrazhit. Vota e Kryetarit është e barabartë me atë të anëtarëve.

Në mbledhjet e Arbitrazhit mund të merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së, mirëpo, vetëm në cilësinë këshill-dhënëse dhe pa të drejtë vote ose vendim marrjeje.

Neni 5

Arbitrazhi vendos për çështje statusore, ku përfshihen:

- Anëtarësia e klubeve dhe shoqatave në FBK
- Statusi i lojtarëve
- Kontestet e transfereve të lojtarëve ose regjistrimit të lojtarëve
- Kontestet kontraktuale klub - lojtar
- Kontestet ndërmjet klubeve ose anëtarëve të FBK-së

Arbitrazhi, po ashtu, vendos në shkallë të dytë në rast të ankesave:

- Në vendimet e Komesarit të Garave.
- Në vendimet e Komisionit për Kalim dhe Regjistrim.
- Në vendimet e Komisionit Disiplinor.

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 6

Ankesa në Vendimet e Komisioneve nga neni 5 i kësaj Rregulloreje parashtrohet me shkrim dhe duhet të përmbajë:

- Emërtimin e personit që ankohet.
- Bazën juridike të ankimit.
- Faktet në të cilat mbështetet ankesa (provat materiale) dhe
- Të saktësohet se i drejtohet Arbitrazhit të FBK-së

Neni 7

Pala e cila ankohet, duhet ta paguaj taksën e caktuar me këtë rregullore, në ditën e paraqitjes së ankesës, dhe atë:

- Për ankesën kundër vendimeve të Komisarit të Garave500 €
- Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Kalim dhe Regjistrim300 €
- Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit Disciplinor300 €

Pavarësisht prej miratimit apo jo të ankesës së parashtruar taksa në vlerën 120 € nuk i kthehet ankuesit.

Në qoftë se ankesa aprovohet, shuma e mbetur e të hollave i kthehen ankuesit.

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 8

Klubet të cilat parashtrojnë ankesë, mundën që në procedurë të përfaqësohen edhe nga personat e autorizuar, të cilët nuk janë përfaqësues zyrtar të klubeve.

Të drejtën nga paragrafi i këtij neni e kanë edhe personat e tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen në Arbitrazh.

Neni 9

Arbitrazhi duhet të bie vendim, në afatet e përcaktuara në Propozicionet e Garave, Rregullore për Kalimin dhe Regjistrimin e lojtarëve dhe Rregulloren Disiplinore.

Në qoftë se nuk është prezent njëri anëtar i Arbitrazhit, ai mund të deklarohet me shkrim, në lidhje me ankesën nëpërmjet postës elektronike.

Vendimi i Arbitrazhit duhet të përmbajë:

- Emrin e plotë të lëndës
- Përbërjen e Arbitrazhit
- Përshkrimin e procesit të trajtimit të lëndës
- Vendimin
- Arsyetimin

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 10

Arbitrazhi gjatë punës së vet, duhet të vendos në bazë të parimit të çmuarjes së lirë të provave, akteve normative të FBK-ës dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Gjatë trajtimit të lëndës, Arbitrazhi mund të vendosë për:

- Anulimin – në rast se lënda është dorëzuar jashtë afateve, nuk është bërë pagesa sipas nenit 7, është dorëzuar nga personat e pa autorizuar ose nuk përbën lëndë për arbitrazh
- Refuzimin e ankesës/kërkesës – rrjedhimisht konfirmimin e vendimit të shkallës së parë
- Miratimin e ankesës/kërkesës – dërgimin në rishqyrtim të lëndës në shkallën e parë
- Miratimin e ankesës/kërkesës – anulimin e vendimit të shkallës së parë

Neni 11

Arbitrazhi gjatë marrjes së vendimeve, duhet të përdorë vulën katrore dhe atë të rrumbullakët të FBK-ës.

Mbledhjet e Komisionit Arbitrar i thërret Sekretari i FBK-ës.

Neni 12

Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa.

Neni 13

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i FBK-ës.

Kuvendi i FBK-së

Mitrovicë, 19.02.2017

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

